



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 3544 Prot.

Shkodër më 14.11 2022

URDHËR

Nr. 86, datë 14/11/2022

PËR HAPJEN E PRANIMEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM", NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë", Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Luigj Gurakuqi, si dhe në zbatim të Urdhrit të MAS, Nr. 174, datë 4.4.2022, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në 'Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm', në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër,

URDHËROJ:

1. Hapjen e pranimeve në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në 'Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm', në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër.
2. Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" në 'Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm', në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër, do të kryhen nga data 14.11 2022 deri më datë 24.12. 2022.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Rektori

Nr. 3544/1

Shkodër 16.11.2022

FUSHAT E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË"

Fushat e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" janë si më poshtë:

Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", me nënfusha

- a. Shkenca shoqerore
- b. Shkenca humane dhe arte
- c Shkenca natyrore
- d. Shkenca shendetit

REKTORI
Prof. Dr. **Shkëlqim Golemi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Rektori

Nr. 3544/
12

Shkodër 14.11.2022

Njoftim

HAPEN PRANIMET NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË" NË UNIVERSITETIN E SHKODRES "LUIGJ GURAKUQI"

Universiteti i Shkodres, bazuar në Urdhërat e Rektorit të USH-së, Nr.86 dt.14.11.2022 , si dhe në zbatim të "Rregullores së Studimeve të Doktoratës", njofton hapjen e pranimeve në studimet e ciklit të tretë

1. "Doktoratë" në 'Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm' (20 kuota)

Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" , do të kryhen nga data 14.11.2022 deri më datë 24.12.2022.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Rektori

Nr. 3544/13

Shkodër 14.11.2022

**DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR REGJISTRIM NË
STUDIMET E CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË"**

(Përmbajtja e Dosjes individuale)

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Curriculum Vitae me foto personale
2. Letër motivimi
3. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës dhe dy fotografi
4. Vertetim rajoni për adresën/rezidencën e banimit
5. Kopje e noterizuar të diplomave dhe listës së notave të studimeve ose certifikata të njehsimit të tyre nga Ministria e Arsimit në Shqipëri
6. Dëshmi e gjuhës së huaj (kopje e noterizuar) që verteton plotësimin e kriterit për gjuhën e huaj
7. Dy rekomandime prej personelit që gëzon titull akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit
8. Vërtetim nga qendra e punës që vërteton se kandidati ka minimumi dy vite angazhim si personel akademik pranë një IAL, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
9. Propozimi i kandidatit për kërkimin shkencor që do të zhvillojë në përputhje me projektet kërkimore të miratuara dhe/ose fushat e nënfushat kërkimore të miratuara për këtë program studimi
10. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin
11. Vetëdeklarim i kandidatit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor e publikimit
12. Deklaratë vetjake e kandidatit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës
13. Mandat pagese për tarifën e aplikimit në ALL.

REKTORI
Prof. dr. Suzana Çolmi
SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Rektori

Nr. 3544/14

Shkodër 14.11.2022

**Kriteret që duhet të plotësojë kandidati në programin "Doktoratë" në
"Ekonomi dhe Turizëm i Qendrueshëm"**

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qendrueshëm" si më poshtë:
 - a) Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë të pakten njëren nga diplomat 'Master i Shkencave', 'Master i Arteve', 'Diplomë të Intëguar të Nivelit të Dytë', 'Diplomë e Nivelit të Dytë', 'Diplomë Master Ekzekutiv', 'Diplomë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të pro esit të Bolonjës', apo diplomë nga një program studimi të barasvlefshëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga ministria e arsimit në Shqipëri
 - b) Të ketë notë mesatare të përgjithshme në studimet e ciklit të parë dhe të dylë të studimeve jo më pak se 8.00 ose të ketë fituar jo më pak se 80% të pikëve totale nga vlerësimi përkatës për studimet e kryera jashtë vendit
 - c) Të ketë dëshmi të zotërimit të njëres prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në nivel C1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
 - d) Të ketë dy rekomandime prej personelit me titull akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
 - e) Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij, apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike në programin e studimeve.
2. Krite specifike
 - a) Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë të pakten një diplomë: 'Master i Shkencave', 'Master i Arteve', 'Diplomë të Intëguar të Nivelit të Dytë' 'Diplomë e Nivelit të Dytë', 'Diplomë MastEr Ekzekutiv', 'Diplomë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të proqesit të Bolonjës' ose ekuivalente me të, në fushen e Ekonomisë/Turizmit ose në fusha të ngjashme dhe/ose të ndërlydhura me fushen e Doktoraturës, si në:
 - Shkenca shoqërore (Psikologji, Sociologji, Drejtësi, Gjeografi, Media dhe Komunikimi);
 - Shkenca Humane dhe Arte (Histori, Gjuhët e huaja, Artet);
 - Shkenca natyrore (Shkenca e biologjisë, Shkenca mjedisore, Shkenca kompjuterike);
 - Shkenca e shëndetit.

